



PARIMET E BESIMIT
ISLAM

ISMAIL BARDHOSHI

Parimet e Besimit Islam

Parimet e Besimit Islam

bazuar në librin “Tri Parimet”

Botohet nën kujdesin e Azem Bardhoshit, imam i
xhamisë Yzberisht - Tiranë

Dy fjalë

Broshura që keni në dorë shërben si manual i parimeve të besimit Islam dhe, si e tillë është shumë e përshtatshme për fillestarët. Këtë libërth mund ta përdorë prindi në familje për tu mësuar fëmijëve parimet e besimit; mund ta përdorë imami i xhamisë për të mësuar xhematin; mësuesi për të mësuar nxënësit etj.

Ky material ribotohet pas rishikimit dhe krahasimit të tij me origjinalin. Në botimin e mëparshëm u vunë re pjesë të shtuara, që nuk gjendeshin tek origjinali, të cilat u lanë ashtu siç ishin. Paraqitja e parimeve të besimit Islam në formë pyetje përgjigje është shumë praktike për mësimin, kuptimin dhe rrënjosjen e tyre.

Parimet e Besimit Islam

Në emër të Allahut,
të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit

Pyetje: Cilat janë katër gjërat që duhet t'i mësojmë?

Përgjigje: 1- Dija: të njohim Allahun, të njohim të Dërguarin e Tij, të njohim fenë Islame me argumente nga Kurani dhe Suneti; 2- Zbatimi i kësaj dijeje; 3- Thirrja në këtë dije; 4- Durimi në vështirësi.

Allahut i Lartësuar thotë: “(Betohem) për kohën. Me të vërtetë njeriu është në humbje të sigurt, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin”. (El-Asr 1-3)

Imam Shafiu për këtë sure ka thënë: “Sikur Allahu të mos u zbriste njerëzve tjetër gjë nga Kurani, përveç kësaj sureje, ajo do t’u mjaftonte.”

Pyetje: A duhet të jetë deklarimi i dëshmisë "la ilahe il-lallah" dhe zbatimi para dijes, apo më parë duhet dituria dhe pastaj deklarimi i dëshmisë dhe zbatimi me vepra?

Përgjigje: Dija është para tyre, sipas kuptimit të fjalës së Allahut të lartësuar: “Mësoje se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut! Kërko falje për mëkatet e tua!” (Muhamed, 19)

Buhari thotë: “Më parë duhet të dish, pastaj të flasësh e të veprosh.”

Pyetje: Cilat janë tri çështjet që duhet t’i mësojë medoemos çdo musliman e muslimane dhe të veprojnë sipas tyre?

Përgjigje: E para: Allahu na ka krijuar, na ka furnizuar dhe nuk na ka lënë pas dore, por ka dërguar te ne një të dërguar, kush i bindet, do të

futet në Xhenet dhe kush e kundërshton do të futet në Zjarr.

Argument për këtë është fjala e Allahut: “Ne, me të vërtetë, ju kemi sjellë një të dërguar (Muhamedin a,s) dëshmitarë mbi ju, ashtu siç ia çuam një të dërguar (Musain) Faraonit, por Faraoni nuk iu bind të dërguarit (Musait) kështu që Ne e mbërthyem atë me ndëshkim të ashpër...” (Muzemil, 15-16)

E dyta: Allahu i lartësuar nuk pranon që njerëzit të adhurojnë bashkë me Të ndonjë gjë tjetër, qoftë melek (engjëll), qoftë pejgamber i dërguar.

Argument për këtë është fjala e Allahut: “Xhamitë janë për adhurimin e Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!” (Xhin, 18)

E treta: “Kush i bindet të dërguarit të Allahut dhe njëson Allahun, nuk i lejohet që të miqësohet me atë

që kundërshton Zotin dhe të dërguarin e Tij, qoftë ai edhe njeriu më i afërt i tij.”¹

Argumenti për këtë është fjala e Allahut: “Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të kenë dashuri ndaj atyre, që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, dhe nëse ata janë baballarët e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Allahu ka skalitur besim në zemrat e tyre dhe i ka forcuar me ndihmën e Vet. Ai do t’i dërgojë ata në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me

¹ Pohimi i sipërcituar duhet të kuptohet në përputhje me thënien e Allahut: “Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.” (Mumtehine 8). Ne nuk i quajmë vëllezër në fe ata të cilët nuk e besojnë Zotin ashtu siç besojmë ne dhe që nuk janë muslimanë, por nga ana tjetër, ne bashkëjetojmë me ta, nuk u cenojmë jetën dhe pasurinë dhe sillemi në mënyrë njerëzore me ta, pa u bërë asnjë të keqe, madje u bëjmë dhe mirësi kur kemi mundësi.

Allahun. Ata janë Pala e Allahut dhe, vërtet që Pala e Allahut janë të shpëtuarit.” (Muxhadele, 22)

Pyetje: Ç’është “feja e drejtë e Ibrahimit”?

Përgjigje: Feja e drejtë e Ibrahimit është të adhurosh Allahun një të vetëm, sinqerisht. Në këtë fe i ka urdhëruar Allahu të gjithë njerëzit dhe për këtë i ka krijuar.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë.” (Dharijat, 56)

Pyetje: Ç’do të thotë fjala “adhurojnë”?

Përgjigje: Ata i besojnë, i falen dhe i luten vetëm Allahut që është një i vetëm, që urdhëron dhe ndalon.

Pyetje: Cila është gjëja më e madhe që ka urdhëruar Allahu?

Përgjigje: Njësimi i Allahut (Teuhidi).

Pyetje: Ç'është Teuhidi?

Përgjigje: Ai është veçimi i Allahut në adhurim.

Pyetje: Cila është gjëja më e madhe që ka ndaluar Allahu?

Përgjigje: Shirku (idhujtaria, t'i bësh shok Allahut).

Pyetje: Ç'është shirku?

Përgjigje: Të adhurosh të tjerë veç Allahut ose bashkë me Të.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë...”. (En-Nisa 36); “Prandaj mos i vini shokë Allahut, duke e ditur!” (Bekare, 21-22)

Tri parimet _____

Pyetje: Cilat janë tri parimet që njeriu duhet t'i njohë, t'i zbatojë në praktikë dhe t'i përhapë?

Përgjigje: Njeriu duhet të njohë Zotin e vet, fenë e vet dhe të dërguarin e Zotit, Muhamedin a.s.

Parimi i parë: Njohja e Zotit _____

Pyetje: Kush është Zoti yt?

Përgjigje: Zoti im është Allahu që me mirësinë e Tij më ka krijuar dhe kujdeset për mua dhe mbarë gjithësinë. Ai është i adhuruari im, nuk kam të adhuruar tjetër përveç Allahut.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve.” (El-Fatiha, 1)

Çdo gjë tjetër përveç Allahut është botë (krijesë). Edhe unë jam një prej krijesave.

Pyetje: Mbi ç’bazë e ke njohur Zotin tënd?

Përgjigje: Zotin e kam njohur nëpërmjet argumenteve të Tij dhe gjërave që Ai ka krijuar: nata dhe dita, Dielli dhe Hëna, shtatë qiejt dhe Toka, si dhe çfarë ka në to dhe ndërmjet tyre.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Nga shenjat e Tij janë nata dhe dita, dielli dhe hëna; mos i bëni sexhde, as diellit dhe as hënës, bëjini sexhde vetëm Allahut që i ka krijuar ato.” (Fusilet 37). Po ashtu fjala e Allahut: “Në të vërtetë, Zoti juaj (Rab) është Allahu, që krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë e pastaj u lartësua mbi Arsh. Ai me natën mbulon ditën që ndjek me të shpejtë mbulimin e dritës. Dielli, hëna dhe yjet janë

nën sundimin e Tij. Vërtet Atij i përket krijimi, rregullimi i punëve të krijesave, urdhërimi dhe ligjvënia. I Madhëruar është Allahu, Zoti i botëve!” (Araf, 54)

Pyetje: Ç’do të thotë besimi se Zoti është një e i pashoq në veprat e Tij (Rab).

Përgjigje: Të besosh Zotin si Krijues dhe Sundues të gjithçkaje dhe si rregulluesin e vetëm të punëve të krijesave. Përderisa Allahu është Krijuesi, Sunduesi dhe Rregulluesi i vetëm i punëve të krijesave, atëherë vetëm Ai meriton të adhurohet.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të bëheni të përkushtuar. I Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin e ka ndërtuar me përsosmëri, i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim. Prandaj mos i vini shokë Allahut, duke e ditur!”

(Bekare, 22-23). Ibn Kethiri ka thënë: “Vetëm Krijuesi i këtyre gjërave është Ai i cili meriton të adhurohet.”

Pyetje: Ç’është adhurimi (ibadeti)?

Përgjigje: Adhurimi (ibadeti) është kulmi i përunjesisë dhe i nënshtrimit, i dashurisë dhe i besnikërisë ndaj të cilit e bën. Me fjalë të tjera, adhurimi është përmbledhës i të gjitha bindjeve, ndjenjave e gjendjeve shpirtërore, fjalëve dhe veprave, të cilat i do dhe i pëlqen Zoti.

Pyetje: Sa lloje adhurimesh (ibadetesh) ka urdhëruar Allahu xh.sh.?

Përgjigje: Allahu ka urdhëruar shumë lloje adhurimesh, fjala vjen: Islami (dorëzimi dhe nënshtrimi ndaj Allahut), imani (besimi i vërtetë i cili përfshin besimin e drejtë në zemër, pohimin e besimit me gjuhë dhe veprimin sipas mësimëve të Islamit), ihsani (përsosja e adhurimit), lutja, frika²,

² Këtu nuk është fjala për frikën e natyrshme, si: frika prej egërsirës, mbytjes në ujë etj., pasi kjo nuk është shirk, por

varja e shpresës për të arritur atë që dëshiron, mbështetja³, dëshira për arritjen e shpërblimit të Zotit, tmerri prej dënimit të Zotit, përlulja (devocioni ndaj Zotit), droja, kthimi me pendim, kërkimi i ndihmës, kërkimi i mbrojtjes, kërkimi i shpëtimit⁴,

për frikën e adhurimit. Kësisoj, frika prej zemërimit dhe dënimit të Allahut është adhurim ndaj Tij, kurse frika prej një tyrbeje apo një vendi të ashtuquajtur të mirë është shirk.

³ Mbështetja tek Allahu për të plotësuar nevojat dhe për të larguar të këqijat është adhurim ndaj Tij, ndërsa mbështetja tek të vdekurit, tyrbet apo vendet e ashtuquajtura të mira, duke menduar se të sjellin dobi apo të largojnë nga të këqijat, është shirk.

⁴ Kërkimi i ndihmës, mbrojtjes apo shpëtimit është lutje, dhe siç dihet lutja është adhurim, kështu që nëse dikush kërkon ndihmë, mbrojtje apo shpëtim prej të vdekurve, ai bën shirk. Kërkimi prej të vdekurve vjen nga besimi se ata kanë aftësi dhe pushtet të fshehtë apo se ata bëjnë veprime të fshehta në gjithësi. Ndërsa nëse kërkon ndihmë, mbrojtje apo shpëtim prej të gjallëve në gjëra që ata mund t'i kryejnë, kjo nuk është shirk.

kurbani, zotimi ⁵, të gjitha këto dhe të tjera adhurime që Allahu ka urdhëruar, duhen bërë vetëm për Allahun e Madhërueshëm.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Xhamitë janë për adhurimin e Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!” (Xhin, 18)

“Ndërsa Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuroni asgjë tjetër përveç Tij, dhe që të jesh respektues ndaj prindërve.” (Isra, 23)

Pyetje: Ç’qëndrim mbahet ndaj atij personi që ndonjë nga adhurimet e lartpërmendura ia kushton dikujt tjetër përveç Allahut?

Përgjigje: Ai që i kushton ndonjë adhurim dikujt tjetër veç Allahut, është idhujtar, jo musliman (mushrik, kafir).

⁵ Zotimi do të thotë: të marrësh përsipër të kryesh një rit fetar, si: namaz, agjërim, therje kurban etj.. Kështu, nëse dikush zotohet të therë kurban për diçka tjetër veç Allahut, ai bën shirk.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Ai që krahas Allahut lut zot tjetër, duke mos pasur kurrfarë prove për këtë, me siguri do të japë llogaria vetëm te Zoti i tij. Me të vërtetë, nuk ka shpëtim për femohuesit (kafirat).” (Mu’minun, 117)

Pyetje: Cili është argumenti se lutja është adhurim?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Zoti juaj ka thënë: “Lutmëni Mua, se do t’ju përgjigjem. Me të vërtetë, ata që nga mendjemadhësia nuk duan të më adhurojnë Mua, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar.” (Gafir, 60). Dhe fjala e të dërguarit të Allahut: “Duaja është palca e adhurimit.” Ose sipas një thënie tjetër profetike: “Lutja është vetë adhurimi.”

Pyetje: Cili është argumenti se frika është adhurim?

Përgjigje: Fjala e Allahut: "Ju mos kini frikë prej atyre, por frikësohuni vetëm prej Meje, nëse jeni besimtarë." (Ali Imran, 175)

Pyetje: Cili është argumenti se shpresa është adhurim?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “...kushdo që shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë asnjë në adhurim Zotit të vet.” (Kehf, 110)

Pyetje: Cili është argumenti se “mbështetja në Zotin” është adhurim?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “Vetëm tek Allahu mbështetuni, nëse jeni besimtarë.” (Maide, 23). Gjithashtu Allahu i lartësuar thotë: “...dhe kujtdo që mbështetet tek Allahu, Ai do t’i mjaftojë... .” (Talak, 3)

Pyetje: Cili është argumenti që vërteton se dëshira për arritjen e shpërblimit të Zotit, tmerrri (nga dënimi i Zotit) dhe përlja (devocioni) janë adhurime?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe na luteshin, me dëshirë për arritjen e shpërblimit dhe të tmerruar

prej dënimit . Ata ishin të përlulur dhe të devotshëm ndaj Nesh.” (El-Enbija, 90)

Pyetje: Cili është argumenti se droja është adhurim?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Prandaj, mos u keni dronë atyre, por më keni dronë vetëm Mua”. (El-Bekare, 150)

Pyetje: Cili është argumenti se kthimi me pendim te Zoti është adhurim?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “Kthehuni me pendim te Zoti juaj dhe nënshtrojuni Atij...”. (Ez-Zumer, 54)

Pyetje: Cili është argumenti se kërkimi i ndihmës është adhurim?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm nga Ty ndihmë kërkojmë.” (El-Fatiha, 5). Ndërsa në hadith thuhet: “Nëse kërkon ndihmë, kërkoje prej Allahut.”

Pyetje: Cili është argumenti se kërkimi i mbrojtjes është adhurim?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Thuaj: Kërkoj mbrojtje te Zoti i agimit.” (El-Felek, 1). Si edhe, fjala e Tij: “Thuaj: Kërkoj mbrojtje te Zoti i njerëzve.” (En-Nas, 1)

Pyetje: Cili është argumenti se kërkimi i shpëtimit është adhurim?

Përgjigje: Është fjala e Allahut xh.sh.: “Kur kërkuat ndihmë nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj... .” (El-Enfal, 9)

Pyetje: Cili është argumenti se kurban i është adhurim?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “Thuaj (O Muhamed): “Në të vërtetë namazi im, kurban i im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak...”” (En’am, 161-162); Ndërsa i dërguari i Allahut thotë: “...Allahu e ka mallkuar këdo që ther kurban për dikë tjetër veç Allahut”. (Muslimi)

Pyetje: Cili është argumenti se zotimi është adhurim?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Ata i zbatojnë zotimet e tyre dhe i frikësohen Ditës (së Kiametit) tmerri i së cilës është përhapur gjithkund.” (El-Insan, 7)

Parimi i dytë: Njohja e fesë Islame me argumente _____

Pyetje: Ç’është feja Islame?

Përgjigje: Islami është dorëzimi ndaj Allahut, duke besuar se Ai është një dhe duke e adhuruar Atë të vetëm, nënshtrimi ndaj Tij me bindje dhe largimi nga idhujtaria dhe idhujtarët.

Pyetje: Sa rangje ka feja Islame?

Përgjigje: Feja Islame ka tri rangje: a) Islami (dorëzim dhe nënshtrim ndaj Allahut), b) Imani (besimi me zemër) dhe c) Ihsani (përsosja e adhurimit ndaj Allahut). Secili rang ka shtyllat e veta.

Pyetje: Sa janë shtyllat e Islamit?

Përgjigje: Shtyllat e Islamit janë pesë: dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij; falja e namazit; dhënia e zekatit; agjërimi i ramazanit dhe kryerja e haxhit në shtëpinë e shenjtë të Allahut në Mekë.

Pyetje: Cili është argumenti se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Allahu dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Atij, edhe engjëjt e dijetarët e dëshmuan. Ai e mban Krijimin e Tij në drejtësi të plot. Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij, të Gjithfuqishmit, më të Urtit Gjithgjykues”. (Al-Imran, 18)

Pyetje: Ç’do të thotë “LA ILAHE IL-LALLAH”?

Përgjigje: Do të thotë: “Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.”

Pyetje: Cili është qëllimi i shprehjes “nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut” (la ilahe il-lallah)?

Përgjigje: Qëllimi i saj është mohimi i gjithçkaje që adhurohet veç Allahut dhe pohimi se adhurimi i takon vetëm Allahut, i Cili nuk ka shok në adhurim, ashtu siç nuk ka shok në sundim.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë shpjegim?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “(Kujto) kur Ibrahim i tha babait dhe popullit të tij: “Me të vërtetë që unë jam i distancuar dhe s’kam të bëj fare me ato që adhuroni ju përveç Atij që më krijoi mua dhe padyshim që Ai do të më udhëzojë.” Ai e la të përjetshme atë fjalë ndër pasardhësit e vet, me qëllim që ata të ktheheshin në bindjen e Allahut dhe adhurimin e Tij pa i shoqëruar.” (Ez-Zukhruf, 26-28)

Gjithashtu edhe thënia e Tij: “Thuaj (O Muhamed): “O ithtarë të Librit ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush, se do të adhurojmë vetëm Allahut, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë dhe se nuk do të konsiderojmë njëri-tjetrin si zotër

në vend të Allahut.” Nëse ata nuk e pranojnë, atëherë ju thoni: Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut.” (Al-Imran, 64)

Pyetje: Cili është argumenti se Muhamedi a.s. është i dërguari i Zotit?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Tashmë ju ka ardhur një i dërguar (Muhamedi) nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, dëshiron (lakmon) besimin tuaj dhe përmirësimin e gjendjes suaj dhe është i butë (i ndjeshëm, zemërdhembshëm) e i mëshirshëm për besimtarët.” (Teube, 128). Si dhe fjala e Allahut: “Muhamedi është i dërguari i Allahut, kurse ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër ndaj jobesimtarëve, por të mëshirshëm me njëri tjetrin...” (el-Fet’h, 29)

Pyetje: Ç’do të thotë të dëshmosh se Muhamedi a.s. është i dërguari i Allahut?

Përgjigje: T’i bindesh në gjithçka që ka urdhëruar, të besosh në gjithçka që na ka lajmëruar, të largohesh

nga gjërat që na ka ndaluar, si dhe të adhurosh Allahu sipas mënyrës që ka ligjëruar.

Pyetje: Cili është argumenti i namazit e i zekatit dhe komenti i njësimiit?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “E megjithatë, ata qenë urdhëruan vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë të shmangur nga idhujtaria, si dhe të falin namazin e të japin zekatin. Kjo është feja e drejtë.” (El-Bejine, 5)

Pyetje: Cili është argumenti për agjërimin?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “O ju që besuat, agjërimi është bërë detyrë për ju, ashtu siç ishte detyrë edhe për ata që ishin para jush, që të mund të bëheni të devotshëm.” (El-Bekare, 183)

Pyetje: Cili është argumenti për haxhin?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “...vizita e shtëpisë (Kabes) është detyrë për atë që ka mundësi ta përballoj udhëtimin te ajo. E kush nuk beson (mohon

haxhin si shtyllë të Islamit), atëherë Allahu nuk ka nevojë për askënd.” (Al-Imran, 98)

Pyetje: Cili është rangu i dytë i fesë Islame?

Përgjigje: Rangu i dytë e fesë Islame është imani (besimi).

Pyetje: Sa degë ka imani (besimi)?

Përgjigje: Degët e besimit janë shumë: shtatëdhjetë e më tepër. Më e larta është fjala “la ilahe il-lallah”, kurse më e fundit është largimi i pengesave prej rrugës. Edhe turpi është degë e besimit.

Pyetje: Sa janë shtyllat e imanit?

Përgjigje: Shtyllat e imanit janë gjashtë: Besimi në Allah, në melekët (engjëjt) e Tij, në Librat e Tij, në të dërguarit e Tij, në Ditën e Gjykimit dhe në kader (paracaktimin e gjithçkaje) i mirë apo i keq (qoftë ky për ty).

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, melekët, në Librin dhe të dërguarit...” (Bekare, 177)

Pyetje: Cili është argumenti që Allahu e ka paracaktuar gjithçka, pra se çdo gjë ndodh me kaderin e Allahut?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar.” (Kamer, 49)

Pyetje: Cili është rangu i tretë i fesë Islame?

Përgjigje: Rangu i tretë i fesë Islame është ihsani (përsosja e adhurimit), i cila ka vetëm një shtyllë.

Pyetje: Ç’është ihsani?

Përgjigje: Ihsani është të adhurosh Allahun sikur ti e shikon Atë. E nëse nuk arrin ta adhurosh sikur e shikon Atë, atëherë adhuroje me ndjenjën se Ai të shikon ty.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë muhsininë (punëmirë).” (Nahl, 128). Po kështu fjala e Tij: “Dhe mbështetu tek i Plotfuqishmi, Mëshirëploti, i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit) dhe lëvizjet e tua midis atyre që përuhen në sexhde. Vërtet, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha” (Shuara, 217-220). Gjithashtu edhe fjala tjetër e Allahut: “Në çfarëdo pune që të jesh, çfarëdo gjëje që të lexosh nga Kurani dhe çfarëdo pune që të bëni (o njerëz), Ne jemi dëshmitarë, kur ju e kryeni atë. Zotit tënd nuk i fshihet as një grimë peshe, në Tokë a në qiell; as më e vogël se ajo dhe as më e madhe, nuk mbetet pa u shënuar në Librin e Qartë”. (Junus, 61)

Pyetje: Cili është argumenti nga Suneti i Muhamedit a.s. se feja Islame ka tri ranqe?

Përgjigje: Hadithi i njohur i Xhebrailit, i transmetuar nga Umer bin Hatabi r.a., i cili thotë: “Një ditë ishim duke ndenjur me të dërguarin e Allahut a.s. kur u

duk një njeri me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zeza. Nuk linte përshtypjen se është ndonjë udhëtar dhe asnjë prej nesh nuk e njihte. Ai u ul pranë të dërguarit a.s. duke i mbështetur gjunjët e vet në gjunjët e pejgamberit, duart e veta i vendosi në kofshën e tij dhe i tha: “O Muhamed! Më trego ç’është Islami?” I dërguari a.s. i tha: “Islami është të dëshmosh se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh ramazanin, të kryesh Haxhin në Kabe, në qoftë se ke mundësi për këtë.” Ai iu përgjigj: “Të vërtetën the.” Ne u çuditëm, e pyeste dhe i thoshte të vërtetën the. Pastaj e pyeti: “Më trego ç’është imani (besimi)?” Pejgamberi a.s. tha: “Të besosh Zotin, melekët e Tij, Librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Gjykimit dhe të besosh në kader (paracaktimin e gjithçkaje) i mirë apo i keq (qoftë ky për ty).” Pastaj e pyeti: “Më trego ç’është ihsani (përsosja e adhurimit)?” Pejgamberi a.s. iu përgjigj: “Ihsani është të adhurosh Allahun sikur ti e shikon Atë. E nëse nuk arrin ta adhurosh sikur e shikon Atë,

atëherë adhuroje me ndjenjën se Ai të shikon ty.” Ai e pyeti përsëri peygamberin: “Më trego për çastin e fundit (Kiametin)?” Peygamberi a.s. iu përgjigj: “Për këtë i pyeturi nuk di më shumë se ai që pyet.” Atëherë ai e pyeti përsëri: “Më trego mbi shenjat e tij?” Peygamberi a.s. iu përgjigj: “Kur robëresha të lindë zonjën e vet, kur të shihen barinj të këmbëzbathur, të zhveshur, të varfër, barinj delesh të cilët garojnë në ndërtesa të larta.” Pastaj ai u largua, ndërsa ne qëndruam pak , i dërguari i Allahut a.s. më tha: “O Umer! A e njeh atë që më pyeti?” Unë thashë: “Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më së miri.” Peygamberi u përgjigj: “Ky qe Xhebraili erdhi t’ju mësojë fenë tuaj.” (Muslimi)

Parimi i tretë: Njohja e të dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s. _____

Pyetje: Cili është parimi i tretë?

Përgjigje: Njohja e pejgamberit tonë, Muhamedit a.s. Ai është Muhamedi, i biri i Abdullahut, i biri i Abdylmutalibit, i biri i Hashimit. Hashimi ishte prej fisit Kurejsh. Kurejshët janë fis arab. Arabët prejardhjen e kanë prej Ismailit, të birit të Ibrahimit a.s.

Pyetje: Sa ka jetuar pejgamberi a.s.?

Përgjigje: Pejgamberi ynë, Muhamedi a.s., ka jetuar gjashtëdhjetë e tre vjet, dyzet vjet para se t'i zbriste Shpallja dhe njëzetë e tre vjet si i dërguari i Allahut. Vendlindja e tij është Meka.

Pyetje: Për çfarë e ka dërguar atë Allahu?

Përgjigje: Allahu xh.sh. e ka dërguar atë për të tërhequr vërejtje nga shirku (idhujtaria) dhe të ftoi në Teuhid (në njësimin e Zotit).

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “O ti i mbuluar me rrobat e tua! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje, rrobat e tua pastroji dhe largohu nga

ndyrësia (adhurimi i idhujve). Mos jep gjë, me synimin për të marrë më shumë dhe për hir të Zotit tënd, duro!” (El-Mudethir, 1-7)

Pyetje: Ç’do të thotë “Çohu dhe paralajmëro!”?

Përgjigje: “Çohu dhe paralajmëro!” do të thotë: tërhiq vërejtje njerëzve prej politeizmit dhe thirri në besim të drejtë.

Pyetje: Ç’do të thotë “Zotin madhëro dhe rrobat e tua pastro”?

Përgjigje: Kjo do të thotë madhëro Zotin tënd, duke e njësuar Atë. Ndërsa “rrobat e tua pastro” do të thotë që veprat e tua dhe besimin tënd t’i pastrosh nga politeizmi.

Pyetje: Ç’do të thotë “largoju nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)”?

Përgjigje: Ajo do të thotë: lënia e tyre, distancimi prej tyre dhe prej ithtarëve të tyre.

Pyetje: Sa i ka zgjatur kjo të dërguarit a.s.?

Përgjigje: Ajo i ka zgjatur dhjetë vjet, pastaj bëri udhëtimin në qiell, ku iu urdhërua të kryejë pesë namaze në ditë. Në Mekë është falur tre vjet, pastaj u urdhërua për të emigruar në Medinë.

Pyetje: Ç'është emigrimi?

Përgjigje: Emigrimi (hixhreti) ka dy kuptime: kuptimi i parë është lënia e vendit të idhujtarisë ku muslimanët shtypen për të shkuar në një vend islam apo në një vend ku ata janë të lirë të zbatojnë rregullat e fesë Islame. Kuptimi i dytë është largimi nga gjërat e ndaluara.

Pyetje: Në ç'kategori detyrash bën pjesë emigrimi?

Përgjigje: Ai është detyrë e domosdoshme e muslimanit qoftë për t'u larguar nga vendi ku ai shtypet, apo për t'u larguar nga veprimet e ndaluara nga Allahu.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut xh.sh.: “Kur melaiket ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me

faje, thonë: “Ku ishit?” Ata përgjigjen: “Ishim të pafuqishëm në Tokë.” Melekët do t'u thonë: “A nuk ishte toka e Allahut e gjerë që të mërgonit në të?” Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi; sa vend i keq është ai! Me përjashtim të burrave të pa fuqishëm, gra dhe fëmijë, të cilët nuk kanë mundësi të gjenin ndonjë rrugëdalje dhe nuk janë në gjendje të drejtohen në rrugë, mbase Allahu do t'i falë, se Allahu me të vërtetë është Shlyes dhe Falës i gjynaheve.” (Nisa, 97-99). Si dhe fjala e Allahut: “O robërit e Mi, që keni besuar! Toka Ime është vërtetë e gjerë, andaj më adhuron vetëm Mua!” (El-Ankebut, 56)

Pyetje: Cili është shkaku i zbritjes së këtyre dy ajeteve?

Përgjigje: Shkaku i zbritjes së ajetit të parë është se një pjesë e popullsisë së Mekës pranuan Islamin, por nuk u shpërngulën në Medinë me pejgamberin a.s megjithëse kishin mundësi për të emigruar.

Në lidhje me ajetin e dytë Begaviu Allahu e mëshiroftë ka thënë: “Shkak i zbritjes së këtij ajeti

ishin muslimanët në Mekë që nuk emigruan, Allahu u drejtohet atyre duke i quajtur besimtarë.”

Pyetje: Cili është argumenti nga Suneti mbi vazhdimësinë e emigrimit?

Përgjigje: Fjala e të dërguarit Muhamed a.s.: “Nuk do të ndërpritet emigrimi derisa të mos ndërpritet pendimi, e pendimi nuk do të ndërpritet derisa Dielli të lindë andej nga perëndon.”

Pyetje: Çfarë urdhëroi i dërguari a.s. pasi u vendos në Medinë?

Përgjigje: Muhamedi a.s. urdhëroi edhe detyra të tjera Islame, siç janë: zekati, agjërimi, haxhi, thirrja për falje (ezani), xhihadi, urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja e të tjera nga kodi i Islamit (Sheriati).

Pyetje: Sa kohë e ka vazhduar këtë i dërguari i Allahut a.s.?

Përgjigje: Ai e ka vazhduar për dhjetë vjet, derisa vdiq, kurse feja e tij ka vazhduar dhe kjo është feja e

tij. Nuk ka ndonjë të mirë vetëm se ia ka treguar umetit të tij, e as nuk ka ndonjë të keqe vetëm se ia ka treguar umetit të tij.

Pyetje: Cila është ajo e mirë të cilën urdhëroi dhe cila është ajo e keqe nga e cila paralajmëroi?

Përgjigje: E mira në të cilën e udhëzoi popullin është njësimi (Teuhidi) dhe gjithçka që do Zoti dhe që është i kënaqur me të, ndërsa e keqja për të cilën qortoi dhe ndaloi është idhujtaria dhe gjithçka që e urren Allahu xh.sh.

Pyetje: A e ka dërguar Allahu peygamberin për një grup, për një popull të caktuar apo për mbarë njerëzimin?

Përgjigje: Allahu e ka dërguar Muhamedin a.s. peygamber për mbarë njerëzimin si dhe për xhinët, dhe për të gjitha kohërat, deri në ditën e Kiametit.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i dërguar i Allahut për të gjithë ju... .” (El-Araf, 158)

Pyetje: Allahu a e ka plotësuar fenë me Muhamedin a.s. apo ajo u plotësua pas Tij?

Përgjigje: Po. Zoti e plotësoi fenë me Muhamedin a.s. Pas tij feja nuk ka nevojë për asgjë.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj...”. (El-Maide, 3)

Pyetje: Cili është argumenti për vdekjen e Muhamedit?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Sigurisht që ti (o Muhamed) do të vdesësh një ditë e, sigurisht që edhe ata do të vdesin. Pastaj, në Ditën e Gjykimit, ju do të grindeni para Zotit tuaj!” (Ez-Zumer, 30-31)

Pyetje: A do të ringjallen njerëzit pas vdekjes apo jo?

Përgjigje: Po, do të ringjallen. Sipas fjalës së Allahut: “Ne ju kemi krijuar prej Tokës, aty do t’ju kthejmë dhe prej saj do t’ju nxjerrim edhe një herë tjetër”. (Ta Ha, 55). Po kështu fjala e Allahut: “Allahu ju ka krijuar nga toka, ashtu si bimët, pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t’ju nxjerrë.” (Nuh 17-18)

Pyetje: A do të japin llogari njerëzit dhe a do të shpërblehen për veprat e tyre pas ringjalljes?

Përgjigje: Po, do të japin llogari për veprimet e tyre dhe do të shpërblehen. Në Kuran thuhet: “... për t'i shpërblyer ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta, e për t'i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë.” (En-Nexhm, 31)

Pyetje: Si konsiderohet ai që e mohon ringjalljen?

Përgjigje: Ai që e mohon ringjalljen konsiderohet jobesimtar (kafir), sipas argumentit të Kuranit: “Ata që nuk besuan, mendojnë se nuk do të ringjallen kurrësi. Thuaju: “Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjallen dhe pastaj do të njoftoheni për atë ç’keni

bërë! Dhe kjo është e lehtë për Allahun.”” (Tegabun, 7)

Pyetje: Me ç’mision i dërgoi Allahu të dërguarit?

Përgjigje: Allahu i dërgoi të dërguarit për të përgëzuar me Xhenet besimtarët dhe për të paralajmëruar me zjarrin e Xhehenemit ata që nuk besojnë ose që i bëjnë shok Allahut.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Të dërguar që kanë qenë përgëzues dhe paralajmërues në mënyrë që njerëzimi të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve...” (En-Nisa, 165)

Pyetje: Cili është i dërguari i parë?

Përgjigje: I dërguari i parë është Nuhu.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “Ne të frymëzuam ty (o Muhamed) me shpallje, ashtu siç frymëzuam me shpallje Nuhin dhe profetët pas tij... .” (En-Nisa, 163)

Pyetje: A ka mbetur ndonjë popull pa i dërguar Allahu peygamber që ta urdhërojë të adhurojë Allahun një të vetëm dhe të largohet nga adhurimi i tagutit (idhujve)?

Përgjigje: Nuk ka mbetur asnjë popull pa u dërguar peygamber. Kjo vërtetohet me argumentin e Kuranit: “Çdo populli Ne i kemi çuar një të dërguar (që u thoshte): Adhuroni vetëm Allahun dhe shmanguni nga taguti (idhujt)!” (Nahl, 36)

Pyetje: Ç’është taguti?

Përgjigje: Tagut është: "Çdo gjë ndaj të cilës njeriu i tejkalon kufijtë, duke e pasuar, adhuruar ose duke iu bindur."

Pyetje: Sa është numri i tagutëve?

Përgjigje: Numri i tyre është i shumtë, por më kryesorët janë pesë:

- 1-Iblisi (Shejtani) mbi të qoftë mallkimi i Allahut,
- 2-Ai që adhurohet dhe është i kënaqur me adhurimin që i bëhet.

3-Ai që i fton njerëzit në adhurimin e tij.

4-Ai që pretendon se di të fshehtë.

5-Ai që nuk gjykon me ligjin që ka zbritur Allahu.

Allahu na ka urdhëruar që të mos u besojmë këtyre, të largohemi prej tyre dhe të jemi muslimanë.

Pyetje: Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Fjala e Allahut: “S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra. Ai që mohon tagutin (idhujt dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, është kapur në lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu është Gjithëdëgjuesi i Gjithëdituri”. (Bekare, 256)

Kjo është domethënia e fjalës LA ILAHE IL-LALLAH. “nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut”. Ndërsa në hadith përcillet: “Kreu i çështjes është Islami, shtylla e tij është namazi dhe kulmi i tij është xihadi në rrugën e Allahut”.

Allahu është më i dituri! Lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi profetin tonë, Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| DY FJALË _____ | 3 |
| PARIMET E BESIMIT ISLAM _____ | 3 |
| TRI PARIMET _____ | 9 |
| Parimi i parë: Njohja e Zotit _____ | 9 |
| Parimi i dytë: Njohja e fesë Islame me argumente _____ | 19 |
| Parimi i tretë: Njohja e të dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s. _____ | 28 |
| PËRMBAJTJA _____ | 41 |